

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari, Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen juridiko-civile të paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ne seli në Prishtinë, qe e përfaqëson [REDAKTUAR] avokate shtetërore me autorizim,kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fsh.[REDAKTUAR]Hani Elezit, për çështjen kontestuese Pasurim i pa bazë, pas mbajtjes së shqyrtimit përgatitor oral dhe publik më dt.07.04.2017, në prezencën e të autorizuarës së paditësit dhe në mungesën e të paditurit mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e ushtruar më dt.23.02.2011,kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fsh.[REDAKTUAR]Hani Elezit,me të cilën ka kërkuar kthimin e mjeteve në emër të pasurive të pa bazë.

II. DETYROHET, pala paditëse që ta paguaj shumën prej 30€, në emër të taksës për padi dhe aktgjykim,e cila pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratojë në tërësi si të bazuar,dhe ta detyroj të paditurin që ta paguaj shumën prej 1455€,si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Ka theksuar se i padituri pas vdekjes së antarit të familjes ka tërhequr shumë në vlerë prej 1455.00€, nga pensioni bazë sipas autorizimit por në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 par.2.4 dhe nenit 7 par.7.5 të Udhzimit Adm.08/2007 për ndalesat e pagesave të pensionit bazë.

Paditësi të paditurin e ka njoftuar lidhur me rastin,dhe i njejtë pas tërheqjes së vrejtes në afatin ligjorë nuk ka shprehur mirëkuptim dhe gadishmeri për kthimin e mjeteve të tërhequra pa bazë ligjore,nga këto baza ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë ta miratojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar për taksa gjyqësore.

I padituri në seancat e mbajtura gjyqësore kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar dhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta refuzojë për arsye se menjëherë pas vdekjes së nënës të njejtën e ka lajmëruar se ka vdekur, dhe është bërë nderprerja e pensionit.

Poashtu ka theksuar se nuk ka qenë person i autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe pala paditëse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se unë kam qenë i autorizuar dhe e kam bërë tërheqjen e mjeteve.Nga këto baza ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e bazuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile, gjykata bëri leximin e këtyre provave të shkruara: u lexua procesverbali mbi konstatimin në vend direkt,regjistri për kthimin e mjeteve, raporti i vdekjes,çertifikata e vdekjes,historiati i pagesave dhe kërkesa e dt.01.02.2017,pa pyetje pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lirë të kësaj gjykate, kjo gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

I padituri si ka tërhequr pensionet pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit, dhe nuk ka qenë person i autorizuar për tërheqjen e pensionit,paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i padituri ka qenë i autorizuar dhe e ka bërë tërheqjen e mjeteve.

a) Se i padituri si ka tërhequr mjetet financiare pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit , këtë fakt gjykata e vërtetoi nga procesverbali mbi konstatimin në vend direkt i dt.20.05.2010,ku tani i padituri ka deklaruar se nuk i ka tërhequr mjetet pas vdekjes së nënës dhe ka kërkuar nga personat kompetent se të zbulohet se kush i ka tërhequr këto mjete.

Poashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklaratat e të paditurit i cili në seancat e mbajtura gjyqësore kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar duke theksuar se këto mjete nuk i ka tërhequr.

b) Se i padituri nuk ka qenë person i autorizuar për tërheqjen e pensionit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës si dhe nga regjistri për kthimin e mjeteve,ku në kolonën 36 është shënuar emri i shfrytëzueses,ndërsa në kolonën e parafundit tek personat e autorizuar nuk ka të shënuar se kush është i autorizuar por as emri i të paditurit nuk figuron si person i autorizuar.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, kërkesëpadinë e paditësit e refuzoi në tërësi si të bazuar për arsye se pala paditëse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i padituri ka qenë i autorizuar për tërheqjen e pensionit, poashtu nuk e kanë vërtetuar me asnjë provë se i njëjti e ka bërë marrjen e këtyre mjeteve, e këto fakte gjykata i vërtetoi nga procesverbali i dt.20.05.2010,nga regjistri për kthimin e mjeteve dhe deklarata e të paditurit.Gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte kërkesëpadinë e paditësit e refuzoi në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit për arsye se me procesverbalin e dt.01.02.2017,e ka detyruar palën paditëse që për seancën e radhës gjykatës të i'a prezentojë dëshminë se kush e ka bërë tërheqjen e pensionit për periudhën kontestuese, mirpo pala paditëse gjykatën nuk e ka informuar as kush ka qenë person i autorizuar as kush i ka marrë këto mjete,andaj gjykata duke i pasur për bazë këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarës së paditësit, e cila i propozoj gjykatës qe padinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin që ta paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këto theksime, gjykata nuk i mori për bazë dhe të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara, për arsye se pala paditëse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se keto mjete i ka tërhequr i padituri, poashtu me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i njëjti ka qenë i autorizuar dhe ka pasur të drejtë që ti marr mjetet në emër të shfrytëzuesit të pensionit.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e palës së paditur, e cila i ka propozuar gjykatës që kërkëspadinë ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, mirpo këto theksime gjykata i miratoi si të bazuara dhe kërkëspadinë e paditësit e refuzoi në tërësi si të bazuar, sepse pala paditëse me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se pala e paditur ka qenë e autorizuar për tërheqjen e mjeteve, poashtu nuk e ka vërtetuar se i njëjti i ka tërhequr këto mjete.

Gjykata e detyroi palën e paditëse që ta paguaj shumën prej 30€ edhe atë shumën prej 15 €, në emër të taksës për padi dhe shumën prej 15 €, në emër të taksës për aktgjykim. (të parapara sipas udhëzimit administrativ nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësorë) , gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Siç u theksua më lartë dhe në bazë të rezultatit të tërë procedurës lidhur me çështjen kontestimore juridiko –civile kjo gjykata gjykoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr 73/11 prej dt.07.04.2017

Gjyqtari

**Riza LIVOREKA**



UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

